

AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
ALBANIAN ENERGY SUPPLIER 2 SH.P.K.

DATË 02.09.2021

Sot, në datën 02.09.2021, pala e mëposhtme:

Shoqëria Balfin-Balkan Finance Investment Group sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar me NUIS K72223031K pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me seli të regjistruar në adresën: Rr. Papa Gjon Pali II, ABA Center, Kati 11, Tiranë, përfaqësuar nga Znj. Edlira MUKA, shtetase shqiptare, e lindur në Tiranë, në datën 03/02/1983, e identifikuar nga letërnjoftimi me nr. 034271384 dhe me numër personal I35203147R, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e administratores së Balfin sh.p.k..

në përputhje me Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 'Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare', i ndryshuar dhe legjislacionit të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet nënshkrimit të këtij Akti Themelimi, ka vendosur të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të emëruar 'Albanian Energy Supplier 2' sh.p.k.. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj bashkëlidhur këtij Akti si Shtojca A, i cili konsiderohet pjesë thelbësore e Aktit të Themelimit.

Neni 1 – Emërtimi

- 1.1 Është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "Albanian Energy Supplier 2" sh.p.k. (këtej e tutje referuar edhe si "Shoqëria").
- 1.2 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

Neni 2 – Forma

- 2.1 Shoqëria "Albanian Energy Supplier 2" SH.P.K., themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, dhe rregullohet prej këtij Statuti dhe Aktit të saj të Themelimit.
- 2.2 Shoqëria vepron në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 3 – Selia

- 3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: **Rruga 'Brigada e 8', Pallati 19, kati 3, Ap. 3, Tiranë, Shqiperi.**
- 3.2 Asambleja e Përgjithshme mund të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, degë dhe/ose zyra përfaqësimi dhe njësi vendore të çdo lloji.

Neni 4 – Objekti

- 4.1 Shoqëria ka për objekt veprimtarie kryerjen e aktiviteteve të listuara më poshtë:
 - a. Import, eksport, tregtim dhe furnizim me shumice dhe pakice të energjisë elektrike;
 - b. Ndertimi, zhvillimi dhe menaxhimi i impianteve, sistemeve, të prodhimit, shpërndarjes, transmetimit të energjisë elektrike;
 - c. Shitja, blerja, dhenia me qira e pasurive të paluajtshme;
 - d. Ofrimi i shërbimeve të konsulences, projektimit inxhinierik dhe asistencës teknike.
 - e. Çdo veprimtari tjetër që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të Shoqërisë dhe që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar në fuqi

Neni 5 – Kohëzgjatja

- 5.1 Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 5.2 Shoqëria mund të priset në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 6 – Kapitali i Shoqërisë, kontributet dhe kuotat

- 6.1. Kapitali i Shoqërisë i nënshkruar është 300,000,000 Lekë (treqind milionë lekë), i përbërë nga 1 (një) kuotë me një vlerë nominale prej 300,000,000 Lekë (treqind milionë lekë).
- 5.2 Kapitali i Shoqërisë zotërohet tërësisht nga ortakut i vetëm:

Shoqëria Balfin-Balkan Finance Investment Group sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar me NUIS K72223031K pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me seli të regjistruar në adresën: Rr. Papa Gjon Pali II, ABA Center, Kati 11, Tiranë, përfaqësuar nga Znj. Edlira MUKA, shtetase shqiptare, e lindur në Tiranë, në datën 03/02/1983, e identifikuar nga letërnjoftimi me nr. 034271384 dhe me numër personal I35203147R, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e administratorës.
- 5.3 Duke u bazuar në sa më sipër:
 - o Balfin-Balkan Finance Investment Group sh.p.k. zotëron 1 (një) kuotë, e barabartë me 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Neni 7 – Transferimi i Kuotave

Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen, tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 8 të Statutit.

Neni 8 – Administratori/ët

- 8.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkarisht përveçse kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratorët do të qëndrojnë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje, ose në përputhje me afatin e emërimit të tyre (deri në 5 vjet), me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovohet automatikisht edhe për një vit tjetër.
- 8.2 Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha fuqitë e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.
- 8.3 Administratori/ët mund të emërojë përfaqësues me prokurë speciale ("*ad negotia*") për kryerjen e një akti ose kategori aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre.
- 8.4 Personi i mëposhtëm caktohet dhe emërohet si Administratori i parë i Shoqërisë, për një afat emërimi prej 3 (tre) vitesh:

"Z. Bers Hado, shtetas shqiptar, i lindur më 06.11.1982 në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. I21106094C, dhe me numër personal 032004662"

Neni 9 – Gjuha

Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

Neni 10 – Dispozita të Fundit

10.1 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.

* * *

NË DËSHMI TË SA MË SIPËR, Pala deklaron se ky Akt Themelimi dhe Statuti bashkëlidhur si Shtojca A, është në përputhje me vullnetin e saj dhe për këtë arsye e nënshkruan atë në datën e sipërshtuar, me vullnet të plotë dhe të lirë.

ORTAK I VETËM

BALFIN-Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.

Përfaqësuar nga:

Znj. Edlira MUKA

